

**V E N D I M**  
**Nr. 327, datë 12.7.1999**

**PËR DHËNIEN E FONDEVE BUXHETORE PËR SKEMËN E TRAJTIMIT  
ME STREHIM TË FUNKSIONARËVE POLITIKË DHË TË  
NËPUNËSVE CIVILË TË ADMINISTRATËS SË LARTË  
SHTETËRORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 12 të ligjit nr. 8095 datë 21.3.1996 “Për shërbimin civil në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjit nr. 8439, datë 29.12. 1998 “Për Buxhetin e shtetit të vitit 1999”, me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave të përdoren 150 000 000 (njëqind e pesëdhjetë milionë) lekë për skemën e trajtimit me strehim të funksionarëve politikë dhe të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore.

2. Ky fond të transferohet në Bankën e Kursimeve, e cila ngarkohet për zbatimin e rregullave në përputhje me kriteret, termat dhe procedurat e përfitimit të kredisë të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 102, datë 5.3.1999 “Për trajtimin me strehim të funksionarëve politikë dhe të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Pandeli Majko**